ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-24-13374-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik të DSHAM-it**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**global CT Digital Kosovo SH.P.K.**
NUI	**811405936**
Adresa	**Hyzri Talla, nr. 58, kati 3, nr. 12**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Digital Kosovo**
Adresa elektronike	**digitalkosovo@globalct.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**13.01.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik të DSHAM-it

Projekti ne fjale eshte publikuar me daten: 19.12.2024. Brenda afatit kohor per sqarime shtese kompania jone ka dorezuar kerkesen per sqarime dhe me daten 03.01.2025 jane publikuar sqarimet nga ana e Autoriteti Kontraktues.

Me daten 04.01.2025 kompania jone ka dorezuar kerkeses per rishqyrtim, per te cilen deri me daten 13.01.2025 nuk kemi pranuar pergjigje.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kompania jone ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën: 04.01.2025 pranë autoritetit kontraktues. Kanë kaluar gjithsej 12 ditë kalendarike apo 5 ditë pune dhe ne nuk kemi pranuar asnjë njoftim nga Autoriteti Kontraktkues.

Prandaj, perveç shkeljeve tjera, mendojmë që edhe mos respektimi i nenit 108/A përben shkelje të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit,

dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1.Neni 108/A, paragrafi 6 te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe neni 60, 61 dhe 63 te RRUOPP 002/2024 dhe 001/2024
2.Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
3. Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit I Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Neni 45.14 I Rregullores Nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin E Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik
4. Neni 69 i Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi Ankimor ne mos pergjigjen kundrejte kerkeses per rishqyrtim:

Kompania jone ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën: 04.01.2025 pranë autoritetit kontraktues. Kanë kaluar gjithsej 12 ditë kalendarike apo 5 ditë pune dhe ne nuk kemi pranuar asnjë njoftim nga Autoriteti Kontraktkues.

Pra, Autoriteti Kontraktues pervec qe nuk ka kthyer perjgigje ne kerkesen tone per rishqyrtim, te njejtit nuk e kane pezulluar aktivitietin e prokurimit sic parashihet ne nenin 61.3 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin publik ku është paraparë që: Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shqyrtuar fare kërkesën tonë, andaj konsiderojmë që është shkelur dispozita në fjalë

Gjithashtu në nenin 63 paragrafi 63.2. është përcaktuar që Vendimi mbi refuzimin ose

miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Autoriteti Kontraktues, gje qe nuk ka ndodhue. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtroj një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi Ankimor 1: Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 7 te LPP-se sepse:

- Autoriteti kontraktues me rastin e publikimit te projektit, perfshi ketu sqarimeve shtese ka krijuar parakushte qe eliminojne dhe reduktojne konkurrencen ne mes operatoreve ekonomik dhe poashtu ka krijuar diskriminim te drejteperdrejte te operatoreve tjere ekonomik qe nuk posedojne diplomat dhe certifikimet specifike (pa mundesuar diploma dhe certifikime ekuivalente), te cilat nuk i shtojne vlere ketij projekti aspak dhe mund te plotesohen nga cfaredo diplome apo certifikimi qe eshte ekuivalent me to.
- Autoriteti Kontraktues nuk ka marre te gjtiha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik me rastin e publikimit te ketij projekti.

Pranadj, duke vepruar ne kete form atutorieti kontraktues ka paraqitur kerkesat administrative te projektit jane ne shperputhje me LPP-ne, RRUOPP dhe praktikat e projekteve te tilla.

Pretendimi Ankimor 2: Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 53 te LPP-se dhe nenin 45.14 te RRUOPP nr. 002/2024 sepse:

Autoriteti Kontraktues me rastin e publikimit të sqarimeve shtese nuk e ka shtyer afatin per te pakten dhjete (10) dite nga dita e fundit per dorezimin e tendereve sic specifikohet qarte ne LPP dhe RRUOPP me numer 002/2024 dhe ate citojme (faqe 16, neni 45.14):

45.14 Nëse, gjatë një procedure të hapur, të kufizuar apo konkurruese me negociata, informata shtesë apo sqaruese ofrohen për OE të, dhe data kur ofrohen këto informata është më pak se dhjetë (10) ditë nga afati i fundit për dorëzim të tenderit, AK do të zgjatë afatin kohorë për të dhënë mundësi OE të paktën 10 ditë për dorëzimin e tenderëve duke përgatitur dhe publikuar Njoftimin për Korrigjim të procedurës.

Autoriteti Kontraktues ka publikuar sqarimet me daten 03.01.2025, ndersa afati i fundit per dorezimin e tendereve eshte 10.01.2025, pra 7 dite e jo te pakten 10 sic percaktohet me LPP dhe RRUOPP.

Prandaj, nje veprim i tille cenon shkeljen e LPP-se dhe rrjedhimisht zvogelimin e afatit per aplikim dhe ngushton afatin ligjor per perdorimin e hapave tjere para aplikimin sic percaktohet ne LPP.

Pretendimi Ankimor 3: Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 69 te LPP-se sepse:

- Me kerkesat e paraqitura ne dosjen e tenderit per pjesen e stafit ka eliminuar konkurrencen dhe ka cenuar LPP dhe RRUOPP-ne.
- Po i paraqesim kerkesat e AK-se me poshte:

Kerkesa:

1. Menaxheri i projektit duhet të Ketë Diplomë Universitare, Inxhinier i Kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave inxhinierisë kompjuterike, dhe duhet te kete se paku njërën nga këto certifikatat PMP, Microsoft Power BI, - min. 5 vite përvojë pune dhe të ketë menaxhuar të paktën një (1) projekt të natyrës së njëjte, të zhvilluara njeren nga platformat Microsoft (.NET me SQL Server) dhe Powe BI.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Diploma përkatëse , CV,Certifikat perkatese kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.

Kerkesa:

2. Dy (2) Ekspert për Zhvillimin e Softueri (Programer), duhet të kenë Diplomë në Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike ose Baçelor i shkenca kompjuterike, min. 3 vite në programimin e projekteve të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET) si dhe Ueb shërbimeve dhe WEB API. dhe të jete pjesëmarrës në së paku një (1) projekt në zhvillim softuerit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

2. Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara

Kerkesa:

3. Dy (2) Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave, duhet të kenë Diplomë në Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike, Baçelor i shkenca kompjuterike ose Fakultetin Kompjuterikë me telekomuikacion, min. 3 vjeçare në zhvillimin e bazave të të dhënave në projekte të natyrës së ngjajshme të zhvilluara në platformën Microsoft (baza e të dhënave

në SQL Server). dhe të jete pjesëmarrës në së paku një (1) projekt në zhvillimin e bazave të të dhënave.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

3. Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.

Kompania jone pasi ka analizuar dosjen e tenderit, ka pergaditur kerkese per sqarime shtese duke adresuar pyetjet tona dhe ate si vijon:

Pyetje 1: A eshte e pranueshme qe menaxheri i projektit te jete i diplomuar dhe te mbajne titujt si: Master i Shkencave ne Sisteme te Informacionit?

Pyetje 2: A eshte e pranueshme qe menaxheri i projektit te jete i diplomuar dhe te mbajne titujt si: Master i Shkencave ne Menaxhment?
Pyetje 3: A eshte e pranueshme qe menaxheri i projektit te posedoj certifikim/transcript me titull: Designing Business Inelligence Solutions with Microsoft SQL Server?
Pyetje 4: A eshte e pranueshme qe menaxheri i projektit te jete i certifikuar me ITIL Foundation?
Pyetje 5: A eshte e pranueshme qe menaxheri i projektit te jete i certifikuar si Professional Scrum Master – PSM I?
Pyetje 6: A eshte e pranueshme qe dy ekspertet per zhvillimin e softuerit te jene te diplomuar dhe te mbajne titujt si: Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes (Graduated Electrical Engineer) ne drejtimin teknika kompjuterike, informatike dhe automatike (Computer Technique, Informatics and Automatics)?
Pyejte 7: A eshte e pranueshme qe dy ekspertet per zhvillimin e softuerit te jene te diplomuar dhe te mbajne titujt: Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes (Graduated Electrical Engineer) ne drejtimin elektronike dhe telekomunikacion (Electronics and Telecommunications)?

Pyetje 8: A eshte e pranueshme qe dy ekspertet per zhvillimin e softuerit te jene te diplomuar dhe te mbajne titujt: Inxhnier i Dipomuar i Teknologjise Informative - TI (Graduated IT Engineer) ne drejtimin teknologji informative teknike (Technical Information Technology)?
Pyetje 9: A eshte e pranueshme qe dy ekspertet per zhvillimin e softuerit te jene te diplomuar dhe te mbajne titujt si: Inxhinier i diplomuar i Teknologjise Informative (Graduated Engineer in Information Technology)?
Pyetje 10: A eshte e pranueshme qe dy ekspertet per zhvillimin e bazave te te dhenave te

jene te diplomuar dhe te mbajne titujt si: Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes (Graduated Electrical Engineer) ne drejtimin teknika kompjuterike, informatike dhe automatike (Computer Technique, Informatics and Automatics)?
Pyejte 11: A eshte e pranueshme qe dy ekspertet per zhvillimin e bazave te te dhenave te jene te diplomuar dhe te mbajne titujt: Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes (Graduated Electrical Engineer) ne drejtimin elektronike dhe telekomunikacion (Electronics and Telecommunications)?
Pyetje 12: A eshte e pranueshme qe dy ekspertet per zhvillimin e bazave te te dhenave te jene te diplomuar dhe te mbajne titujt: Inxhnier i Dipomuar i Teknologjise Informative - TI (Graduated IT Engineer) ne drejtimin teknologji informative teknike (Technical Information Technology)?
Pyetje 13: A eshte e pranueshme qe dy ekspertet per zhvillimin e bazave te te dhenave te jene te diplomuar dhe te mbajne titujt si: Inxhinier i diplomuar i Teknologjise Informative (Graduated Engineer in Information Technology)?
Pyetje 14: Tek te gjitha pozitat referncat jane kerkuar ne formen si me siper. Per te plotesuar kete
kriter, a eshte e mjaftushem te dorezohen Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit–
(kopje) ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara?

Referuar Aneksit 1:
Pyetje 15: A posedon Autoriteti Kontraktues kodin burimor te sistemit aktual?
Pyetje 16: A posedon Autoriteti Kontraktues dokumentim te kodit burimor te sistemit?
Pyetje 17: Ne cfare gjuhe programuese eshte zhvilluar sistemi dhe cfare databaze?

Dhe nga Autoriteti kontraktues me daten 03.01.2025 kemi pranuar pergjigjet e pergjithesuara dhe diskriminuese si vijon:

Kriteret e pranueshme per neve jan vetëm sipas dosjes se tenderit ne te cilën jan te saktësuara kërkesat tona profesionale tjerat qoft drejtime te Fakulteteve te cilat nuk ceken ne dosje te tenderit qoft certifikata tjera qe nuk jan cekur psh. dosje si ITL, BI fakulteti i teknologjis informative, Inxhinier i i diplomuar i Elektroteknikes, master i shkencave ne Menaxhment etj. nuk jan te pranueshme

Duke pasur parasysh qe krejt drejtimet e permendura si ekuivalente ne pyetjet tona kane nderlidhje direkte me fusheveprimin e ketij projekti, ne mendojme se AK eshte duke krijuar diskriminim me insistimin e tille dhe poashtu nuk ka asnje arsye se:

Pse duhet Menaxheri i projektit te jete **VETEM** me Diplomë Universitare, Inxhinier i Kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave inxhinierisë kompjuterike **DHE JO DREJTIME** te tjera Master i Shkencave ne Sisteme te Informacionit ose Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes (Graduated Electrical Engineer) ne drejtimin teknika kompjuterike, informatike dhe automatike (Computer Technique, Informatics and

Automatics) ose drejtime tjera ekuivalente. Cka e ben me te vecante drejtimin Inxhinier i Kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave inxhinierisë kompjuterik ne krahasim me drejtimet tjera ekuivalente qe jane permendur?

Pse duhet te insistohet qe Menaxheri i Projektit duhet te jete PMP ose POWER BI e qe rrjedhimisht duke eliminuar keshtu dhe shkaktuar diskriminim duke ditur qe ekuivalente te PMP-se jane edhe certifikimet tjera si Professional Scrum Master – PSM I ose ITIL Foundation ose PRINCE2, duke e pasur te njejtin rol dhe fuqi sikurse PMP,

Poashtu edhe kerkesa dhe insistimi per POWER BI, pamundeson aplikimin me certifikime ekuivalente si Designing Business Inelligence Solutions with Microsoft SQL Server, qe e tejkalon certifikimin ne POWER BI sepse Power BI eshte nje vegel e Microsoft per paraqitje te dhenave ndersa Designing Business Inelligence Solutions with Microsoft SQL Server e trajton komplet procesin nga procesi i transformimit të të dhënave të papërpunuara në informacion deri te pasqyrimi i tyre vizuel.

Pra, pergjigjet e AK-se ne kete pike nuk jane konform LPP-se, RRUOPP-se dhe vendimeve te mehershme nga OSHP per raste te ngjashme ku specifikohet saktesisht qe nje veprim i tille cenon rende LPP-ne dhe Autoriteti Kontraktues do te duhej te merrte te gjitha masat e nevojshme qe mos te behen shkelje te tilla.

Prandaj, kerkojme nga ju si Autoritet Kontraktues qe te:
Mundesoj aplikimin me drejtime ekuivalente shkollore,
Mundesoj aplikimin me certifikime ekuivalente,

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demi material nuk eshte llogaritur ne kete faze.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*